



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (d) të rregullores 2001/19 mbi degen e Egzekutivit të Institucioneve të përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë.

Në pajtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 2.2 të Ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar, Me qëllim të vlersimit dhe verifikimit të mirëfilltë të gjendjes shëndetësore të aplikuesve për pensionet e aftësisë së kufizuar, Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 14/2004
PËR
ANGAZHIMIN E EKSPERTVE MJEKËSOR NË KOMISIONET MJEKËSORE
TË MPMS

Neni 1

Qëllimi i udhëzimit administrative

1.1 Me këtë Udhëzim Administrativ në mënyrë unike, rregullohet angazhimi në punë, kriteret e angazhimit, orari i punës dhe kompensimi financiar i eksperteve të jashtëm medicinal në komisionet mjekësore për të vlersuar dhe shqyrtuar gjendjen mjekësore të kerkuesve të pensioneve me aftësi të kufizuar.

Neni 2

Angazhimi i ekspertve medicinal

2.1 Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale, me qëllim të zbatimit efikas dhe të drejtë të Ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar në Kosovë, do të angazhojë ekspert të jashtëm medicinal në komisionet mjekësore të MPMS për shqyrtimin dhe ekzaminimin e aftësisë së kufizuar të kerkuesve të këtyre pensioneve.

Neni 3

Kriteret e angazhimit

3.1 Komisionet mjekësore të MPMS për shqyrtimin dhe verifikimin e gjendjes shëndetësore të kërkuesve të pensioneve për aftësi të kufizuar, duhet të jenë të përbër nga specialistet e kualifikuar dhe të dëshmuar të fushës mjekësore, si nga dega e mjekësisë së punës, ortopedis, neuropsikiatris etj.

Neni 4

Format e angazhimit

4.1 Ekspertet mjekësor në komisionet mjekësore të MPMS, për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të kërkuesve të këtyre pensioneve, mund të angazhohen me orar të plotë të punës, me gjysmë orar të punës dhe kohë pas kohe sipas nevojave të MPMS, kur është në pyetje mënyra fleksibile e angazhimit të punës të komisioneve mjekësore, kur nuk kërkohet orari i gjatë i punës.

4.2 Me rastin e angazhimit të ekspertëve mjekësor duhet të përfillen me përpikëri dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/09 për oret e punës.

Neni 5

Kompenzimi financiar

5.1 Ekspertët mjekësor të angazhuar në komisionet mjekësore të MPMS në orar të plotë të punës dhe gjysmë orar do të kompenzohen sikurse shërbyesit e tjerë civil të Kosovës. Ekspertët mjekësor të angazhuar në komisionet mjekësore të MPMS kohë pas kohe me orar fleksibil të punës, për pjesëmarrje në séanc ditore do të kompenzohen nga 30 €deri në 40 €.

- Specialistet me 30 €
- Me magjistraturë 35 €dhe
- Me doktoraturë 40 €
-

5.2 Komisioni mjekësor brenda një dite të punës, duhet se paku të vlersoj dhe shqyrtoj 25 kerkesa të kërkuesve të pensioneve me aftësi të kufizuar.

Neni 6

Për personelin mjekësor

- 6.1** Për personelin mjekësor të DAPK-së të angazhuar në cilësi të kryetarit të komisionit mjekësor për angazhimin në séanc jashtë orarit të rregullt të punës i njihet e drejta në kompenzim financiar në shumën prej 30 €
- 6.2** Punëtorët e DAPK-së të angazhuar në punën me komisionet mjekësore jashtë orarit të rregullt të punës dhe ditëve jo punë u lejohej e drejta në kompenzim financiar 15 euro për një séance ditore.

Neni 7

- 7.1** Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përhershëm.

**Sekretari i Përhershëm i MPMS
Ramiz Fazliu**

Prishtinë, korrik 2004
